

Në bazë të nenin 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/18 mbi Taksat Administrative për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, si dhe Pëlqimit të marr nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 753/23 datë 27.02.2023, Komuna e Gjilanit, shpallë këtë:

N J O F T I M PËR DISKUTIM PUBLIK

Njoftohen qytetarët e Komunës së Gjilanit, se nga data 03.03.2023 deri më datë 01.05.2023, do jetë në diskutim publik Taksa Administrative për Leje Ndërtimi dhe Tarifa Rregullative për Infrastrukturës e propozuar për vitin 2023, së bashku me tabelën e shpenzimeve.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë, e propozuar është **1.50€/m²** (një euro e pesëdhjetë cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të, e propozuar është **5.01€/m²** (pesë euro e zeronjë cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimi për kategorinë I dhe II, e propozuar **0.90€/m²** (zero euro e nëntëdhjetë cent për metër katror).

Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturës në lartësi prej 323.23€/për kokë banori.

Qëllimi i diskutimit publik, është që propozimi i lartësisë së taksës administrative, i cili ka marrë Pëlqimin nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 27.02.2022, si dhe tarifa e propozuar për rritjen e densitetit në infrastrukturë, të marr opinionin e qytetarëve, para se të njëjtat të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal.

Komentet e juaja mund t'i dërgoni drejtpërsëdrejti në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, e-malin zyrtar të Komunës së Gjilanit e cila është komunagjilanit@rks-gov.net, nga data 03.03.2023 deri më 01.05.2023.

Taksën dhe tarifën e propozuar, së bashku me tabelën e shpenzimeve, mund ta shkarkoni në vegzën e më poshtme.